

Erjon Uka – Këshilltar

Mban pozicionin e Këshilltarit të Ministrit që prej muajit tetor 2021. Prej shtatë vitesh ushtron veprimtarinë profesionale në fushën e marketingut dhe gazetarisë. Prej tre vitesh mban pozicionin e pedagogut pranë Universitetit Metropolitan Tirana, në fushën Marketingut Dixhital dhe Strategjive Dixhitale. Nga prilli i vitit 2019 deri në tetor të vitit 2021 ka kryer detyrën e Përgjegjës të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut pranë Universitetit Metropolitan Tirana.

Është kontribues në media të ndryshme. Përvojat e mëparshme të veprimtarisë profesionale kanë qenë kryesisht në fushën e komunikimit, të menaxhimit dhe të marketingut, fillimisht në “Universitetin European të Tiranës”, gazeta “Mapo”, portalet online si “Tiranapost.al” dhe “Opinion.al”, pranë “Creative Business Solutions” si dhe në pozicionin e koordinatorit të komunikimit dhe marketingut, pranë “Consulcesi” si konsulent i marrëdhënieve me publikun. Vazhdimisht ndan përvoja në fushën e marketingut si trajnues në kurset profesionale në Digital Marketing & SEO.

Është diplomuar në Informatikë Ekonomike me profil Menaxhim Biznesi, më pas ka përfunduar studimet e ciklit master në Administrim Biznesi me profil Marketing, kohë gjatë së cilës ka ndjekur edhe një shkëmbim studentor në Universitetin e Bolonjës në Itali, në programin International Management.

Ka kryer disa botime dhe artikuj shkencorë në fushën e marketingut dixhital dhe krijimit të strategjive e përmbajtjeve të mediave sociale me fokus kanalet e duhura dixhitale. Zotëron gjuhët e huaja anglisht dhe italisht.

Fusha e angazhimit:

Planifikim, organizim dhe drejtim i strategjive të komunikimit dhe aktivitetet për informimin e publikut pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Koordinim dhe mbështetje logjistike ministrit dhe zyrtarëve të lartë në lidhje me eventet lokale, kombëtare, ndërkombëtare.